

## Vendim nr. 252 datë 28.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marjana Semini, Anëtare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 28.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **KARAFIL BEQIRI**, përfaqësuar nga avokate Vinitra Vidhani, me akt përfaqësimi.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 21-2018-737/38, datë 04.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. 89, datë 29.10.2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2024-382 (56), datë 05.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 64, datë 30.09.2002, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit Karafil Beqiri për veprën penale të vjedhjes me armë me pasojë vdekjen (dy herë), në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 141 dhe 25 të Kodit Penal dhe, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar përfundimisht me 22 vjet burgim. Mbi bazën e apelit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 7, datë 21.01.2003, ka prishur vendimin dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në shkallë të parë.

2. Pas rigjykimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 39, datë 05.05.2005, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale të vjedhjes me armë me pasojë vdekjen në bashkëpunim (dy herë) dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, si dhe caktimin e një dënimi të bashkuar prej 20 vjetësh burgim. Vendimi është prishur sërish nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, e cila, me vendimin nr. 123, datë 21.11.2005, e ka kthyer përsëri çështjen për rigjykim në shkallë të parë.

3. Mbi bazën e rekursit të prokurorit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 489, datë 23.05.2007, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të dytë. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pas rigjykimit, me vendimin nr. 94, datë 19.05.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dënimit të gjykatës së shkallës së parë, duke plotësuar masën e dënimit për një prej akuzave të vjedhjes me armë me pasojë vdekjen. Në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2010-1391 (1016), datë 08.11.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të mbrojtësit të kërkuesit.

4. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit, i cili është përfaqësuar nga dy mbrojtës, respektivisht një mbrojtës i zgjedhur nga familjarët dhe një i caktuar kryesisht, të cilët kanë ndjekur edhe procedurat e ankimit në gjykatat më të larta.

5. Në datën 10.03.2017 kërkuesi është ekstraduar në Shqipëri nga autoritetet greke për qëllime të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit me burgim. Kërkuesi në datën 20.03.2017 ka paraqitur në gjykatë kërkesë për rivendosje në afat të ankimit ndaj vendimit penal të dënimit, me pretendimin se nuk ka pasuri dijëni për akuzat penale dhe se gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2017-558 (45), datë 05.04.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe vendimi i saj është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2017-702/180, datë 15.09.2017, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2018-176, datë 17.04.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

6. Ndërkohë që çështja e ankimit ndaj vendimit gjyqësor për rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit ishte në proces, kërkuesi në datën 08.04.2017 ka paraqitur në

Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimit penal të dënimit, bazuar në nenet 449 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2018-22, datë 16.02.2018, ka vendosur dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2018-737/38, datë 04.05.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, me arsyetimin se: (i) kërkuesi nuk kishte arritur të provonte respektimin e afatit ligjor 30-ditor për paraqitjen e kërkesës; (ii) shkaqet e kërkesës nuk përbënin asnjë prej rasteve të rishikimit të përcaktuara nga neni 450 i KPP-së.

8. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 89, datë 29.10.2018, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: (i) me të njëjtat pretendime kërkuesi kishte kërkuar edhe rivendosjen në afat të ankimit, kërkesë e cila ishte vlerësuar e pabazuar me vendim gjyqësor të formës së prerë; dhe (ii) pretendimet e kërkuesit se nuk kishte pasur dijeni për gjykimin penal ish-in të pabazuara, pasi ankimi ndaj vendimit penal të dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë në vitin 2002 ishte nënshkruar personalisht prej tij.

9. Kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke pretenduar, ndër të tjera, se ankimi ndaj vendimit penal të vitit 2002 ishte nënshkruar nga avokati i caktuar kryesisht, i cili e kishte përfaqësuar atë edhe në gjykimin e çështjes në shkallë të dytë, në përfundim të të cilit gjykata e apelit në vitin 2003 kishte urdhëruar rigjykimin e çështjes në shkallë të parë. Pas shqyrtimit të rekursit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-382 (56), datë 05.03.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, me arsyetimin se ndonëse vendimi i gjykatës së shkallës së parë kishte paqartësi lidhur me shkaqet e parashtruara për rishikim dhe analizën ligjore të provave, gjykata e apelit kishte dhënë përgjigje të arsyetuar në lidhje me pretendimet e kërkuesit.

10. Në datën 01.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.09.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 11.1. *E drejta e mbrojtjes*, pasi procesi penal është zhvilluar në mungesë të tij, ndonëse nuk i është fshehur drejtësisë. Organet shtetërore nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore për njoftimin e tij, mbrojtja është realizuar përmes avokatëve të caktuar nga familjarët dhe kryesisht. Gjykatat e zakonshme duhej të kishin pranuar kërkesën e tij për rishikim, e drejtë kjo e njohur edhe nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe e pranuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*).
- 11.2. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor bazuar në të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi gjykatat kanë dhënë vendimin penal të dënimit bazuar në prova, të cilat sipas nenit 154 të KPP-së, ishin të papërdorshme.
- 11.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, në kundërshtim me Protokollin e dytë shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimet dhe praktikën e saj unifikuese, sipas të cilave vendime *in absentia* konsiderohen ato të dhëna ndaj një personi që nuk ka qenë i pranishëm në gjykim, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së apelit.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues janë kumulative. Në këtë kuptim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesa të mos kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesi legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të

Kushtetutës, pasi kundërshton vendimet gjyqësore të dhëna në procedimin penal ndaj tij, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për pasojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Për sa i takon afatit, Kolegji vëren se për ankimet kushtetuese individuale të paraqitura pas datës 01.03.2017, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 86, pika 3, të ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000”, afati është shkurtuar nga 2 vjet në 4 muaj. Lidhur me llogaritjen e afatit, Gjykata është shprehur se kur kundërshtohen vendimet e Gjykatës së Lartë, ai fillon nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se izolimi i kërkuesit në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale përbën rrethanë që vështirëson marrjen e vendimarrjen e Gjykatës së Lartë nga njoftimi me shpallje (*shih vendimet nr. 45, datë 03.10.2023; nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar edhe procesin gjyqësor të themelit, në përfundim të të cilit është dënuar me 20 vjet burgim. Procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin e datës 08.11.2010 të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 01.08.2024, pothuajse pas 14 vjetëve. Ndërkohë kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit penal të dënimit. Kërkesa është rrëzuar nga gjykatat e zakonshme dhe procesi gjyqësor për shqyrtimin e saj është përmbyllur me vendimin e datës 05.03.2024 të Gjykatës së Lartë.

18. Mbledhja e Gjyqtarëve, në raste të ngjashme, ka theksuar se paraqitja e një kërkesë për rishikim, që nuk pranohet nga gjykata, nuk përcakton ditën se kur vendimi gjyqësor i themelit është bërë përfundimtar, me qëllim llogaritjen e afatit ligjor 4–muajor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Kërkesa për rishikim, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, kur nuk pranohet nga gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor. Në paraqitjen e ankimit kushtetues individual me objekt kundërshtimin e procesit të rishikimit të

vendimit gjyqësor të formës së prerë individët nuk mund të ngrenë pretendime që lidhen me procesin gjyqësor për themelin e çështjes duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor, si mjet i jashtëzakonshëm ankimit, i cili është refuzuar nga gjykata si i pabazuar në ligj (*shih vendimin nr. 183, datë 18.09.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

19. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit që lidhen me procesin gjyqësor të themelit janë paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim *ratione temporis*.

20. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin e rishikimit, Kolegji evidenton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar për këtë proces është ai i Gjykatës së Lartë, që mban datën 05.03.2024. Ky vendim nuk rezulton të jetë publikuar me arsyetim të plotë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, ndërsa kërkuarit i është komunikuar me shkresën nr. 3079/1 prot., datë 13.06.2024 të kancelarit të saj në ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Peqin, ku ai po vuan dënimin me burgim. Lidhur me këtë fakt të fundit kërkuari ka paraqitur edhe vërtetimin e datës 03.07.2024 të lëshuar nga IEVP-ja, Peqin.

21. Kolegji, bazuar në standardet kushtetuese të sipërpërmendura, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin e mospublikimit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe rrethanën e izolimit të kërkuarit, çmon se kërkuari legjitimohet *ratione temporis* për pretendimet lidhur me procesin e rishikimit.

22. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar se vendimet gjyqësore për rrëzimin e kërkesës për rishikim i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së mbrojtjes dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Kërkuari ka parashtruar se vendimet e gjykatave të zakonshme për mospranimin e kërkesës për rishikimin e procesit penal në ngarkim të tij janë marrë në kundërshtim me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm që garanton të drejtën e tij për rishqyrtimin e çështjes penale, si rezultat i gjykimit në mungesë të tij për shkak të mospasjes dijeni. Sipas tij, gjykatat kishin detyrimin të provonin se ai ka pasur dijeni efektivisht për çështjen. Po ashtu, kërkuari ka parashtruar se edhe pse Gjykata e Lartë ka cituar aktet ndërkombëtare që i konsiderojnë në mungesë gjykimit e zhvilluara pa praninë e të pandehurit, në rastin e tij ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

23. Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit bazohen në argumentin se në mospranimin e kërkesës për rishikim gjykatat e zakonshme nuk kanë marrë parasysh dispozitat ligjore në fuqi, praktikën unifikuese, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe

jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me rishikimin e vendimeve penale në rastin e të gjykuarve në mungesë, ndaj Kolegji çmon t’i analizojë ato në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes (*shih vendimin nr. 8, datë 20.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po sipas Gjykatës, duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e kërkesës për rishikim, si mjet i veçantë ankimi, mospranimi i së cilës i heq përfundimisht palës mundësinë për rihapjen e procesit gjyqësor, vendimi gjyqësor për mospranimin e saj duhet të arsyetohet në drejtim të shkaqeve që e kanë çuar gjykatën në marrjen e një vendimi të tillë (*shih vendimet nr. 61, datë 27.09.2016; nr. 36, datë 26.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Mbi bazën e këtyre standardeve kushtetuese, Kolegji do të analizojë nëse, gjykatat e zakonshme në procesin e rishikimit i kanë arsyetuar qëndrimet e tyre në lidhje me pretendimet e kërkuesit për rishikimin e vendimit penal të dënimit, për shkak të gjykimit të çështjes penale në mungesë të tij.

27. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë për rishikimin e vendimit penal të dënimit në datën 08.04.2017, duke pretenduar se i ishte mohuar e drejta e mbrojtjes, pasi nuk ishte vënë në dijeni për gjykimin dhe nuk i ishte fshehur drejtësisë. Sipas tij, interesat e kërkuesit janë përfaqësuar në gjykim nga mbrojtës i zgjedhur nga familjarët ose i caktuar kryesisht. Në kohën e paraqitjes së kërkesës për rishikim, neni 450 i KPP-së nuk parashikonte si shkak rishikimi gjykimin në mungesë dhe kompetente për të shqyrtuar këto lloj kërkesash ishte Gjykata e Lartë.

28. Pas paraqitjes së kërkesës për rishikim, dispozitat e KPP-së ndryshuan, duke parashikuar tashmë se kërkesa për rishikim shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin penal (neni 453 i KPP-së) dhe gjykimi në mungesë sipas nenit 352 të KPP-së përbën shkak për rishikimin e vendimit, me kusht që kërkesa të paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja dijeni (neni 450, shkronja “e”, i KPP-së).



29. Në zbatim të ndryshimeve ligjore, Gjykata e Lartë në datën 16.02.2018 ka vendosur dërgimin e akteve të çështjes së kërkuarit Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Kjo e fundit ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, duke arsyetuar se kërkuari nuk kishte arritur të provonte paraqitjen e kërkesës brenda afatit ligjor 30-ditor dhe se nuk ndodhej në asnjë prej rasteve ligjore që lejonin rishikimin. Po kështu, me vendimin nr. 15, datë 17.04.2003, Gjykata Kushtetuese kishte shfuqizuar fjalët “nga i pandehuri” në nenin 410, paragrafi i dytë, të KPP-së, duke lejuar ushtrimin e së drejtës së ankimit si nga mbrojtësi i caktuar kryesisht, ashtu edhe nga ai i caktuar nga familjarët (*shih vendimin nr. 21-2018-737/38, datë 04.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, faqet 4-6*). Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastrë, e cila ka arsyetuar se ish-in të pabazuara pretendimet e kërkuarit se nuk kishte pasur dijeni për akuzën dhe se gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të tij, pasi ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit për çështjen penale të themelit ishte paraqitur personalisht prej tij. Po sipas gjykatës, ndonëse kërkuari kishte qenë në mungesë, ai ishte përfaqësuar në gjykim nga avokatët e zgjedhur rregullisht prej tij, legjitimimi i të cilëve nuk ishte vënë në diskutim edhe në gjykimet për çështjen e themelit dhe të rivendosjes në afat (*shih vendimin nr. 89, datë 29.10.2018 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastrë, faqet 7 dhe 8*). Vendimi i gjykatës së apelit është vlerësuar i drejtë nga Gjykata e Lartë, sipas së cilës fakti që kërkuari ishte gjykuar në mungesë nuk përjashtonte mundësinë që ai të kishte pasur dijeni për gjykimin në ngarkim të tij. Shkaqet e ankimit ishin paraqitur në gjykatën e apelit personalisht prej tij, ndaj rezultonte se ai kishte pasur dijeni për gjykimin (*shih vendimin nr. 00-2024-382 (56), datë 05.03.2024 të Gjykatës së Lartë, faqet 10-11*).

30. Në analizë të vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, Kolegji vëren se në procesin e rishikimit gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar atyre. Ato kanë vlerësuar se edhe pse kërkuari nuk kishte marrë pjesë në gjykimin penal të themelit, ai kishte pasur dijeni për procesin gjyqësor dhe ishte përfaqësuar rregullisht nga mbrojtësit. Vendimet janë bazuar në faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe përmbajnë bazën ligjore, analizën e provave, mënyrën e zgjidhjes së çështjes, si dhe shkaqet që kanë çuar gjykatat në vendimmarrje. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se, në kundërshtim nga sa pretendohet, vendimet gjyqësore, në tërësi, janë arsyetuar mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ngritura nga kërkuari në procesin e rishikimit.

31. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.



32. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.